

VENDIM
Nr.960, datë 26.11.2010

**PËR LEJIMIN E REALIZIMIT TË PROCEDURAVE DHE SHTYRJEN E AFATIT TË
BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT E TË NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR,
PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT, TË KRYERA NGA MINISTRIA E ARSIMIT DHE
SHKENCËS, INSTITUCIONET NË VARËSI TË SAJ DHE NJËSITË E PUSHTETIT
VENDOR, PËR PUNIMET E PROJEKTEVE TË REJA NË ARSIM, SI AUTORITETE
KONTRAKTORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të paragrafit të tretë të pikës 3/ç të kreut I të vendimit nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, të institucioneve në varësi të saj e të njëjësive të pushtetit vendor, si autoritete kontraktore, për punimet e projekteve të reja në arsim, të realizojnë, brenda datës 31 dhjetor 2010, procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe ndërtime, me fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit, për vitin 2010, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Brenda këtij afati të përfshihen edhe lidhja e kontratave përkatëse dhe publikimi i njoftimit të kontratës së nënshkruar në Buletinën e Njoftimeve Publike.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, institucionet në varësi të saj dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Aneksi 1

N r.	Autoritet kontraktor	Objekti i prokurimit
1	Ministria e Arsimit dhe Shkencës	Blerjen e pajisjeve elektronike të laboratorëve të informatikës për arsimin e mesëm profesional, me fondet e miratuara me vendimin nr.748, datë 15.9.2010 të Këshillit të Ministrave
2	Drejtoritë arsimore dhe zyrat arsimore	Blerja e librave artistikë për rikrijimin e fondit të bibliotekave për vitin shkollor 2010, në të gjitha drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore në rrethe
3	Drejtoritë arsimore dhe zyrat arsimore	Shërbimin e transportit të nxënësve e të mësuesve, në 13 drejtori rajonale arsimore dhe zyra arsimore
4	Drejtoritë arsimore dhe zyrat arsimore	Dokumentacionin shkollor (regjistrat dhe amzat), për vitin shkollor 2010-2011, në të gjitha drejtoritë e rajonale arsimore
5	Ministria e Arsimit dhe Shkencës Institucionet e arsimit të lartë	Blerjen e mallrave, shërbimeve, rikonstruksioneve dhe ndërtimit të objekteve në institucionet e arsimit të lartë, të cilat kanë si burim financimi fonde nga Buxheti i Shtetit, të ardhurat dytësore apo donatorët
6	Komuna Paskuqan	1. Rikonstruksion shkolle 9-vjeçare, Babrru-Qendër

		2. Ndërtim shkolle 9-vjeçare+kopsht Babrru Kodër e Kuqe
7	Bashkia Kamëz	1. Rikonstruksion shkolla e bashkuar “Ibrahim Rugova” 2. Ndërtim kopsht i ri lagje “Bathore 6”, Bashkia Kamëz
8	Komuna Dajt	Ndërtim shkolla 9-vjeçare lagja Qesarakë
9	Komuna Lunik	Rikonstruksion shkolla e mesme “Faik Trungu” Zgosht
10	Komuna Guri i Zi	Ndërtim shkolle 9-vjeçare+ kopsht Vukatanë
11	Komuna Topojë	Shtesë anësore+ sistemim oborri shkolla 9-vjeçare e re Topojë